

Betim Muço

NE
UDHEN
TIVE

8JH-1
198

poezi

814-1

1178.

Betim Muço

NË UDHËN
TIME



poezi

Shtëpia Botuese
«Naim Frashëri»

PËRHERË

(Në vend të parathënies)

Përherë kam të them ca fjalë,
Prushërojnë në mua,
Shumohen e piqen
Dhe plasin sa dalin.

Kur i nis, them, u sosën,
Duart i shtrij në kozmos të shpirtit,
Të tjera fjalë gishtërinjtë m'i djegin.

Përherë kam të them ca fjalë,
Edhe kur do kujtoj se i kam thënë të
gjitha.

DITË, JI E BUKUR

Ditë,

Ji e bukur, sot veçanërisht,
Qoftë për një trill të zakonshëm zgjimi,
Që unë ta ndez cigaren te kongjilli i diellit
Dhe përrenjtë e kaltër qiellorë
T'i mbyl në vorbullat e syve.

Ditë,

Ji e bukur, sot veçanërisht,
Që ta ndiej në papilat e gishtave, prekjen
e gjethit,

Dhe dora të bëhet sy

E syri të bëhet dorë

Dhe buza të pëshpërisë dashurinë e

njerëzve

Pa të cilët ky dhe do të ishte një hiç,

Planet i trishtuar i kotësisë së materies.

Ditë,

Ji e bukur, sot veçanërisht

Tek unë çdo mëngjes

Rilind jeta.

1984

PASMESNATE

*Rrugë e pasmesnatës.
Fshesarët që fshijnë
Asfaltin pahitur nga pluñur i ditës.*

*Yjet vijnë afër.
Në majën e gjethit fle sythi i vesës.
Një e qeshur vajze rrokulliset tutje
Dy fshesaret plaka i hedhin romuze.*

*Paskan punë fshesarët.
Dhe kjo do të thotë:
Dita që kaloi, qe e gjithë e njerëzimit.*

1985

DIALEKTIKE

Mos ma numëro ditën me orë,
Se më del e shkurtër,
E vogël, ajo
Rrahjet e ndryshme të zemrës
S'do t'i kuptosh,
Të asaj këmbane të thjeshtë
Më të shenjtë se shenjtëritë e botës.

Mos ma numëro vitin me ditë,
Se më del monoton
E i zhveshur.
Ashtu nuk m'i njeh dot netët pa gjumë,
Përpjekjen pa fund
Drejtimin e së ndershmes.
Ashtu s'm'i kupton kaç halle e dërte,
Shqetësimin që bën fytyrën e vitit,
Atje ku zë fill koha e nesërme.

Mos ma numëro jetën me vite,
Se e rrafshhtë e zbehtë

Ajo më del,
Si një shkretëtirë sylodhëse
E trishtë,
Si një moçal ujëndenjur që stuhinë s'e njeh.
Ashtu s'do m'i dish dallgët pa fund,
Dashurinë,
Gëzimin e luftës për jetë,
Rritjen time të bukur në kohë
Nga ajo që në ëndërr ka qenë
Tek ajo që e shoh, e dëgjoj dhe e prek.

MË IKU DITA...

Më iku dita
Duke dëgjuar një këngë,
Duke ndier në ajër kërcitjen e krahut të
zogut.

Më iku dita
Në lodrën e ngjyrave
Që dielli krijon me qiellin dhe tokën.

Më iku dita
Me një lule në duar,
Me një det në sy.

Më iku dita me njerëz të mirë
Duke marrë e dhënë me ta mjaltin e zemrës
(Se zemra prodhon më të çmueshmen gjë:
Dashurinë).

Më iku dita
Dhe s'kuptova se si
Por vetëm e ndjeva që jeta më shtohet.

1982

POETI

Zgjatem gjithmonë drejt diçkaje,
E gjithë jeta majë gishtave
Si pema që tenton qiellin.

Po a do të quhej dot jetë
Një rrojtje pa këtë synim?
Numërimi monoton i viteve
Si tespije në duart e plakut të shuar?

Zgjatem gjithmonë drejt diçkaje
I lumturuar nga mundimi i përpjekjes.

1985

KRUJA NATËN

*Një kaci prush
Hedhur brinjës së malit
I kuq
Si gjaku i paprishur i shqiptarit.*

1984

RINIA QESH

Rinia qesh,
natyra ngazëllehet.

Rinia qesh,
kumbon zemra e dheut.

Rinia qesh,
u ndritin sytë qiejve.

I saji është qilimi i blertë i tokës
Dhe deti i paskaj i horizonteve,
Të sajat janë forca dhe shëndeti,
Stoli e vyer e shtatit dhe e mendjes,
Mendimi i kthjellët dhe shpirti,
Pemë e këngës,
Gjithçka që meriton të jetë e bukur.

Rinia qesh,
te gazi i saj rron jeta.

NATËN E MIRË, SAGITË

Natën e mirë, Sagitë!
Njeri i vogël
Që moshën pa fjalë e tregon me tre gishta.

Ti nuk ke gjumë?
Ç'shikon vallë te yjet që pikojnë në xham?
Me një milion pyetje babin e lodhe
Dhe e lumturove me ëndrrën e së ardhmes
sate.

Ishte e diel,
Shëtitëm bashkë.
Te sytë e kësaj dite që ikën
Ka mbetur një zog,
Pa shih, aty qenka një degë mimoze.
Rrugët ku vrapuam,
Këngët që kënduam,
Dhe njerëz, shumë njerëz që i pe e të panë,
Balozit i vrarë nga Gjergj Elez Alia,
Fashisti i vrarë nga xhaxhi partizan.

*Oh, sa e madhe është bota, moj bijë,
Për të menduar!
Oh, sa e bukur është jeta, moj bijë,
Për ta jetuar!*

*Natën e mirë, Sagitë!
Njeri i vogël
Që moshën e tregon me tre gishta.*

1984



BUKURIA

Mos u ngut të thuash fjalën: «Bukur!»
Mos u ngut të thuash fjalën: «Mirë!»
Nëse në shpirtin tënd rrinë zgjuar
Dhe presin fluturimin bukuritë.

S'është fjala për të qenë skeptik
Dhe as për të mohuar jetën,
Para mospëlqimit ndaj kujtdo
Ji i pakënaqur me vetveten.

Mos u ngut të thuash fjalën: «Bukur!»
Mos u ngut të thuash fjalën: «Mirë!»
Masa e bukurisë ka ndryshuar,
Bukuria rritet me njerinë.

SHIU PAS THATËSIRËS SË GJATË

*Kur bie shi pas thatësirës së gjatë
Të duket si një mik i dashur
I pritur nga çasti në çast.*

*Me krehrin e lëngët i kreh flokët ajrit,
Rrëke e përmallur e ujit
Larguar prej tokës.*

*Pikojnë smeralde pemët.
Mullarët në fushë avullojnë,
Zbutet dheu dhe mbyll çarjet e plagëve.
Në gjithë relievin mërmërijnë rrëkerat.*

*Një fshatar ecën udhës,
Këndon një këngë,
Dhe në qerpikë ka dhjetëra diej të vegjël,
Që bëjnë festën e gëzimit të tij.*

*Sa i dashur, i bukur, i ëmbël
Qenka ky shi!*

1985

MIKRONJERIU

Njeriu i vogël — insekt i padukshëm

Në baobabin e madh të jetës.

Qëllimi pse rron:

Interesi i vetvetes.

Diellin e do të vogël

(Mundësisht sa globi i abazhurit),

Detin e do të vogël

(Mundësisht sa govata e fëmijës),

Dhe pyjet i do të vegjël

(Si lulet në saksi).

Hesht, nuk ndihet.

Kollën e shurdhër e mbyt në pëllëmbë,

Fjalën-pëshpërimë ta thotë pranë veshit.

Në çdo truall të shkelë

Gjurmë nuk lë,
Si me të si pa të
Dheu njëlloj e ka peshën.

Njeri i vogël që vegjeton mënjanë,
Me zemrën e trembur sa një kokërr lajthi,
Përpiqesh më kot,
Jashtë klimës së kombit
Nuk ka mikroklimë vetëm në shtëpi.

K R I T I K Ë

Sa herë ndihem mendjemadh,
Këtu pranë detit vij e rri,
Më shuhet mburrja pak nga pak
Dhe bëhem befas si fëmijë.

Pastaj rrudh sytë dhe harrohem
Me largësitë blu në shpirt,
Çdo dallgë që në breg thërrmohet
Është për mua një kritikë.

JETA LIND...

Jeta lind në çdo rrahje të zemrës,
Në çdo thirrje të gjakut
Dhe lëvizje të materies.

Çdo gjë përreth është e gjitha e jotja.
Zgjat dorën dhe preke,
Thirri dhe të përgjigjet,
Gjithësia e tërë
Nga kokrra e rërës te galaktikat.

Mësoi gjuhët e zogjve dhe këngët e erës,
Reflekset e ditës dhe aromat e dheut,
Sepse gjithçka përreth teje e jotja është
Jo për limontinë dhe gjumin e mendjes,
Por që më mirë zemra t'i flasë zemrës
Dhe jeta t'i flasë jetës.

Se ajo lind në çdo rrahje të zemrës
Dhe ka aromën e secilit nga ne.

1984

NË VETEN TIME

Në veten time unë kam një fëmijë,
Ai kërkon të lozë e të qeshet
Dhe s'pyet për hallet e për punët
Po shpesh harrohet në kënaqësinë e lodrës.

Kur do ai të lozë
Los dhe unë me të.
Më thotë: Bëhu kalë!
Dhe unë kalë bëhem, me këmbë m'i rreh
ijet.

Ari bëhu, më thotë
Dhe unë bëhem ari e pall «Uuu!» sa tremb
dhe veten time.

E dua shumë atë fëmijë
Dhe s'më vjen mirë që t'i prishet qejfi.

Në veten time kam një plak,
Fjalët që thotë kanë ar nga mençuria.

Ai pëlqen të heshtë e të mendohet
Dhe unë bëhem heshtje, s'pipëti
Po kur me mua rreh ato që ka menduar
I bëhem shok t'i ndrisë urtësia.

E dua shumë atë plak të mençur
Dhe s'do të doja që t'i prishej qejfi.

Po është hall.

Se kur do plaku të mbyllet në vetvete,
Fëmija s'pyet për të e do të lozë,
Dhe unë si të bëj që mos u prishet qejfi
Në atë apartament të vogël që bën zemrën?

I kam në vete një plak e një fëmijë
Dhe me merakun që ta duan njëri-tjetrin
Jetoj, jetoj
Dhe s'mora vesh si shkuan 40 vjet.

N J E R I U

Unë jam pylli me një milion pemë,
ku secila pemë
Një milion këngë mërmërin.
Të gjitha gjallesat që pylli i ka
Bëjnë jetën e tyre në shpirtin tim.

Unë jam pylli me një milion pemë,
Me vjeshtën, me dimrin,
Pranverën e tij.
Më thahet një degë,
Sythojnë dy të tjera,
I gjelbër jam pa mbarim.

Unë jam pylli me një milion pemë,
I qeshur, i zyrtë,
I heshtur, i bujshëm.
Tek unë fle burimi çapebutë nën fletë
Që bën më tej
Lumin e zhurmshëm.

Unë jam pylli me një milion pemë,
Me majat që ngjallin
Zilinë e rrufeve.
Zjarrin e qiellit e shuaj në shpirt,
Vlagën e tokës
E ruaj në gjethe.

1984

VEGIM

Më ra në sup një aeroplan prej letre
Hedhur nga një fëmijë në katin e pestë,
E mora në duar dhe sytë më qeshën,
Punët prej burri i harrova krejt.

Dita ime e mbushur me punë,
Mendime dhe vrulle, me hall e me gaz,
Kishte nevojë për këtë lodër letre
Ashtu si qielli për zogun ka.

Në veten time u zgjua fëmija,
I vogli, i brishti, i mbeturi ashtu.
I thirri burrit: «Shko ku të duash,
Po mos harro se te ty jam unë!»

NJË FILL BARI

*Këputa një fill bari elegant e të gjelbër
E pyeta për shtëpinë e tokës
E rrugën e diellit.*

*Pak gram klorofile dhe limfe në të,
Milion breza që vdes e rilindet,
Patjetër ai shumë gjëra di
Që i thotë kështu,
Me gjuhën e dridhjes.*

*Oh, sikur këtë gjuhë sadopak ta kuptoja,
Këtë gjuhë të thellë e të brendshme
materie!*

*I lodhur,
Fillin e barit në buzë e vë
Dhe ndiej si rrjedh prej tij
Gjaku i jetës.*

TEK URA E MATIT

*Tek ura e Matit një çast kam qëndruar,
Në katër anë-katër rrugë
Si katër duar.*

*Në çdo udhë të shkoj
Kam shokë dhe njerëz,
Të çmallesha me të gjithë
S'do më dilnin netët.*

*Zemra jo veç gjakun në rrëmba na hedh,
Po dashuri merr
Dhe dashuri jep.*

*Tek ura e Matit një çast kam qëndruar,
Në katër anë-katër rrugë
Si katër duar.*

1983

JAM ROB I BUKURISË NJERËZORE

*Jam rob i bukurisë njerëzore,
Më drithëron në shpirt çdo formë e saj.
Çdo gjë që ka natyra, madhështore,
E tillë është se sy njeriu ka.*

*Gjithçka që ish, që është e do jetë
Në kohën e njeriut rron,
Se është ai që zbukuron planetin,
Ashtu si gjithësinë zbukuron.*

*Ç'kuptim do kish një bukuri pa vlerë
Dhe bukuri a mund të quhej vallë?
Jam rob i bukurisë njerëzore
Dhe i përkulem me nderim asaj.*

HAPAT E MI

*Miliona hapa në udhën time,
Hapa të lehtë,
Hapa të rëndë.
Ka ndodhur — këmbët s'i kam ndier,
Ka ndodhur — këmbët më kanë shpënë.*

*Miliona hapa në udhën time
Shpërndarë tutje-tëhu në shpinë të kohës,
Mbi baltë, mbi asfalt, mbi shkallë, mbi
parket.*

*Çdo hap ka zërin e tij
Dhe flet.*

*Miliona hapa në udhën time,
Pergamenë të zverdhur nga vitet i mbledh
në pëllëmbë,
Si vizatime abstrakte fëmijësh,
Mozaik i çuditshëm,
Jetën time bëjnë.*

1984

QYTETI I STUDENTËVE

Trishtohem sa herë vij këtu,
Këtë më duhet ta pranoj,
Nga ritmi i tyre dalin hapat
Dhe dörën flokëve u shkoj.

Trishtohem sa herë vij këtu
Te ky qytet gjithmon' i ri,
Një qeshje vajze diku pranë
Një pyll kujtimesh zgjon në gji.

Trishtohem sa herë vij këtu
Dhe zemrën time grusht e mbledh,
Mes qindra djemsh me zogj në shpirt
Veten kërkoj e nuk e gjej.

Ku është vetja ime, ku?
Unë kam ndryshuar, s'jam ai,
çdo gjë që jeta më ofron
Me tjetër sy e shoh tani.

*Shikoj përreth e s'di ku shkoj,
Sikur vij nga planeti Mars,
E di që kam të them kaq shumë,
Po ja,... trishtohem dhe nuk flas.*

*Zëra që nga larg
më vijnë*

RRËNJËT

Njeriu ka rrënjë më të thella se pemët,
Shkul një pemë,
Dy barrë dhé merr me vete;
Shkul një njeri
Merr një mijë jetë, një mijë vdekje.

1981

ECI MBI TY

*Toka ime, toka ime,
S'të flas me ndjenjën e pronës,
Të flas me ndjenjën e shpirtit.
Nuanca jote dritëhije
Është epiderma e lëkurës sime.*

*Toka ime, toka ime!
Dua të zgjatem i etur mbi ty,
Të prek fytyrën tënde të një moshe me
kohën
Dhe të eci e të eci...
I dehur nga dashuria jote.*

1984

QEMAL STAFA

Te ky shteg rende të çaje rrethimin,
Maji kish mbushur pesë ditë,
Lufta kish mbushur tre vjet.
Dhjetëra herë
Bari për t'u rimbirë është tharë
Dhe prapë për ty flet.

U flet për ty zogjve që e prekin me flatra,
Diellit që e puth,
Ledhatimit të flladeve,
Insekteve zhurmuese të stinës,
Fluturave, bletëve, djemve dhe vajzave.

Përkulem mbi të.
S'kërkoj tërfilin katërfletësh,
Dua të ndiej rrëfimin për ty.

*Le të mbijë bari te ky shteg, Qemal,
Në shtegun e mendimit tënd
Kurrë s'mbin bar.*

1983

AT DHEU

I ngjita malet më të larta
Dhe nuk të pashë të gjithin,
Atdheu im.

Vetëm në mal të zemrës kur kam dalë
Të pashë si rilind.

Nuk je veç kështjellat dhe toka e lashtë,
As dasmat e mortet
Dhe djepet e varret e arbrit në dhë e në gur,
Nuk je vetëm malet, buzëdetet e fushat,
As shqipja që hesht krenarisht në flamur.

Ti — jemi ne, Atdheu im.
Shkruar thellë në zemra çdo gjë që ke e të
përket,
Me alfabetin gjenetik të çdo njeriu.

Ne — jemi ti
Dhe ti — je ne,

*Nga plaku që jetën e lë
Ë gjer te fëmija që në këmbë është ngritur.*

*Ti rron tek ne,
Tek ti ne rrojmë,
Më madhështorja simbiozë.*

DHJETË VARIACIONE PËR GJERGJ ELEZ ALINË

(poemë)

1.

Buzët mbledhur ndënë dhëmbë,
Zemra mbledhur kraharorit,
Fjalët lësh në lug të gjoksit.
Rëndoi loti dhe pikoi
Mbi kllapinë e të vëllait.

«O moj kullë, mos qofsh në këmbë,
Që nuk prite vdekjen time,
Po ma hedh gjerbën mbi krye»!

«Jo, vëlla, mos qofsha unë,
Tha e motra e vrerosur,
Dhe kallkan m'u bëftë qerpiku
Që i shkau lot i rëndë.
Një bajloz erdhi nga deti,
Tokën i kërkon fshatarit,
Delet i kërkon çobanit;
Armët do prej luftëtarit,

Diell e hënë do prej nesh,
Gazin do nga syri i foshnjës,
Nga çdo bimë njerëzore
Lëngun do që ta thëthijë
Ky bajloz i zi nga deti.»

2.

Shkrofëtiu toka si një kalë
Kur i hipën kalorësi i huaj,
Rrahu zjarr potkoi i saj i sertë.
Qysh u bëka dheu si njeriu,
Qysh u bëka shkëmbi si fëmija,
Qysh vajtoka lulja si një çupë
Dhe qan ahu si një plak i moçëm?!

Mbi gjithë hapësirën e paanë,
Tej e tej ku kokrrat lidhte jeta,
Në eklips ish dielli i lirisë.

3.

Motërzo, moj lule e paluluar,
Që s'të lodhi nëntë vjet vetmia,
Që s'të mpiu nëntë vjet mundimi,
Që në sy s'të mbiu cipa e qiellit
Po maisja e plagëve të mia.
Motërzo, moj blerim i pasosur,
Që s'të prekën duart ty fëmijë

Po melhem për plagët që më dergjën.
Bëji tët vëllai një shërbim të fundit,
Sillmi pranë kalin dhe takëmet
Ta shikosh që ende s'jam i vdekur.

Motërzo, moj lule e paluluar,
Fllad që zbut zjarrminë e tët vëllai.

4.

Pragu u drodh nga këmba e të zotit,
Kish nëntë vjet pa u shkelur nga kjo
këmbë.

Kali u drodh nga pesha e kalorësit,
Kish nëntë vjet pa e ndier këtë peshë.
Palla u drodh nga dora e shpatarit
Kish nëntë vjet pa e ndier këtë dorë.
Toka kish tretur nëntë dëborë dimrash
Dhe nëntë breza lulesh pemët kishin
çelur.

Ai ra në gjunjë bri kullës së tij
Dhe dheun e murrinë shtrëngoi gjer rrëzës
së thonjve,
U bë i gjithi zë e buçiti:
Ku je ti, bajloz, që tokën në zi po dashke
ta vësh?!

5.

Qysh nëntë vjet që diellin s'e ke parë,
Ngjyrën e kullës balli yt ka marrë,
Nëpër dasmat tona s'na ke ardhur,
Nëpër lodra gjokun nuk ta pamë,
Në gëzime gazin nuk ta ndjemë,
Veç prej gjëmës së bajlozit të zi
Qenke ngritur, Gjergj Elez Ali, në këmbë?!

Jo prej gjëmës së bajlozit të zi
Dhe as për pazar të trimërisë,
Po për dasmat që mbas sodit vijnë,
Ku do jem gjithmonë dasmor i parë,
Po për lodrat që mbas sodit vijnë,
Ku do jem gjithmonë lojtar i parë,
Për gëzimet që mbas sodit vijnë,
Ku do jem gjithmonë gazmor i parë.
Jo prej gjëmës së bajlozit të zi,
Njerëz të mi, jam ngritur sot në këmbë.

6.

(Po ç'ishte vallë ky bajloz i zi
I dalë nga humnera e detit?
A kishte pallë, a pushkë, a bombë atomike,
A kishte çallmë, helmetë a borsalinë,
A kishte «republikë» a «astrahan»?
Dhe ç'gjuhë fliste nga fjalori i botës?

Legjenda hesht.

Nga ç'vende kishte ardhur,

Nga ç'stepa, pyje e anëdete?

Dhe ç'erë binin lulet larg te vendi i tij

Dhe ç'ngjyrë sillte muzgu dhe agimi

Dhe ç'djep i kish mëkëmbur vogëlinë?

Legjenda hesht.

Po veç një gjë e dimë:

Shkruar mbi ballë kishte një emblemë

Të njëjtë për çdo okupator të botës,

Vdekja e tij ajo emblemë ish.)

7.

Erdhën nëpër natë ambasadorët,

Helm ata i kishin buzëqeshjet.

«Rri ti, Gjergj, i thanë, në shtrat të vdekjes
sate

Falur ty t'i ka bajlozi kullën, shpatën,
kalin,

Falur ta ka motrën bukuroshe

Sepse ka respekt trimi për trimin,

Sepse ka respekt burri për burrin.

Pse ta marr nga vdekja, paska thënë,

Prenë që në kosë ajo e ka gatitur?!»

8.

Shkoni e i thoni zotit tuaj

Se shumë pak ka dhënë për Gjergj Elez

Alinë.

Po më falka gjithçka kam të miat,
S'po më jepka hise për nga dielli
S'po më jepka hise për nga hëna,
Ajrin po ma djeg me erë të tij të qelbur,
Tokën po ma ndyn me majmërinë e tij.

Shkoni e i thoni zotit tuaj,
A ma lë të lirë erën e malit,
A ma lë të lirë zogun e pyllit,
A ma lë të lirë fjalën e buzës,
A ma lë të lirë hapësirën
Nga kjo hije gjakatare e tij
Që mos shihte vdekjen e mejdanit?

Heu, sa pak ka dhënë ai për Gjergj Elez
Alinë,
Shkoni dhe i thoni zotit tuaj.

9.

Po i thotë mali Gjergjit: «Jam me ty!»
Po i thotë fusha: «Jam dhe unë!»
Po i thonë pemët, lulet: «Jemi ne!»
Po i thotë era: «Të ndihmoj!»
Po i ardhkan njerzit: «Na ke ne
Probatin e përmbi probatinë!»

U përplas gjoku me gjokun
Dhe fitoi ai që ngrënë kish tagjinë e kësaj
fushë
U përplas çeliku me çelikun

Dhe fitoi ai që dalë kish nga gjiri i këtij
mali.

Dhe rrëshqanthi e tërhoqi Gjergji
Trupin e shkalafitur të bajlozit.
Û vrenjt mali: «Mos ma lerë këtu!»
Foli fusha: «Jo mbi barin tim!»
I thotë lumi: «Larg nga këto ujra!»
Korbat krakëritën: «Na helmove!»
Dhe iu lut ky detit:
«Nga ti erdhi, nga ti le të shkojë
T'i përkasë vendit që e sollti.»

10.

Kaluan shekuj dhe e kërkova
Varrin e Gjergj Elez Alisë.
I pyeta fushës çdo rrënjë bari,
I pyeta malit çdo gur prej stralli,
I pyeta ujrat që s'plaken kurrë,
Shtjellat e ajrit që thinjin kohën:
«Ku është varri i Gjergj Elezit?»
Dhe m'u përgjigjën të gjithë radhë:
«Kërko në vete!»

1976

DASHURIA

Dashuri, o zog i qiellit,
Krahëshpërndritura diellore,
Fluturon nga lindja e jetës
Përmes zemrash njerëzore.

Herë bilbil e herë fajkua
Heshtjerëndë a këngëtar,
Sa jam gjallë të kam ndjekur
Dhe s'kam mundur të të kap.

Më ke ndenjtur shpesh ti pranë,
E kam ndier afshin tënd,
Sa jam zgjatur më ke lënë
Si dhuratë, veç një pendë.

Prapë me hov të vija prapa
Shpresëndezur, sedërmadh,
Dashuri, o zog i qiellit,
Dashke qiellin për kafaz.

*Fluturo, po mos na ikë,
Prekna ti me krahun tënd,
Dhe mos daltë gënjeshtari
Që do mburrej, të ka zënë.*

1980

URA

Te kjo urë e vogël,
Mbi Lanë,
E mban mend?
Ne ndesheshim shpesh dikur.
Ura dridhej.
Dridhej vetë apo dridhej nga unë?!

1983

SHEGËT

*Mbrëmë gjithë natën fryu erë
Dhe shega e oborrit,
Në xham të dritares
M'u përplas pa pushim.*

*U gdhi.
Dhe shegët të gjitha
Ishin çarë në degë.
Ëndrrën time për buzët e tua
Pohonin tani.*

1977

M B R Ë M J E

Mbrëmja pa veten në asfaltin e lagur,
Pishat bënë iso për shiun që ndali,
Telefoni i postës i prishur, për dreq,
Dhe befas, për ty më zu malli.

U ndamë të dy zemëruar,
Një shekull më parë, sot në mëngjes,
Dhe s'di si u rrit pa kuptuar
Inati i kotë, pikëçuditëse mes nesh.

Tani shqelmoj gurët e vegjël të rrugës
Në mbrëmjen e lagur, me shi,
T'i fale djalin që ditka ca gjëra
Po s'ditka të sillet me ty.

1978

ME TY

A mund ta gjesh të gjithë qiellin në një sy,
Gjithë njomësinë e bimëve në një buzë,
Këngët e gjithë zogjve në një zë,
Prekjen e oqeanit në një dorë,
Dehjen e gjithë pijeve në një trup,
Jetën e gjithë jetëve në një njeri?

Ç'ka të çuditshme vallë?
Jam me ty.

1978

MËNGJES

Vjershë' shumë e bukur.

Gjithë natën deti lojti me ty
Dy valëza të vogla të la nën sy.

Ti ngrihesh ngadalë, rënduar pak je,
Me buzë në gaz, barkun tënd sheh.

Dhe dorën ma merr, aty ma mbështet,
«Lëvizi, më thua... Lëvizi, e ndien?»

Ç'ke parë, vallë, këtë natë në ëndërr
Që je kaq e mirë, që je kaq e ëmbël?

Apo ngaqë deti ka lojtur me ty,
Kur iku, të la gjerësinë në sy?

1980

PAGJUMËSI

Më doli gjumi mbrëmë dhe mendova për ty,
Kisha parë kaq ëndrra dhe s'mbaja mend
asnjë.

Yjet ishin varur përmbi xham
Ndër thekët e shallit blu të natës,
Cigaren e fikur u ndeha ta ndez
Te prushi i Orionit të largët.

Më doli gjumi mbrëmë dhe mendova për
ty,
Mëngjesi si mjellmë atje tej rrihte krahët.

1976

LIRIKË

Në hapësirën tej e tej
Që nga pemët gjethet bien,
Digjen hurmat nëpër vjeshtë
Porsi zjarrthe dashurie.

Shok i vjetër, zemra ime,
Pse u trete në trishtim,
Vdes gjithçka që vlen të lindet,
Ka një fund për çdo fillim.

Që nga bari, push i dheut,
Gjer tek ylli thellë në qiell,
S'ka kush jetë të përjetshme,
Vjen një ditë edhe vdes.

Mbetet vetëm dashuria
Që njeriu ka veti,
Zemra ime, shok i vjetër,
Mos më lër pa dashuri!

1985

ATË DITË

Atë ditë gjithë qielli ishte imi
Të miat qenë gjithë hapësirat,
Më pëshpëriste toka:
Jam jotja!
Pemët i lumturonte prekja ime,
Lulet më thoshin: Çelemi për ty!
Gëzimi yt na mban në ajër,
Thoshin zogjtë.

Atë ditë
Gjithçka që e rrit jeta ishte imja,
Vetëm ti ishe e tjetërkujt.
Dhe unë e ndjeva se sa zhvleftësoheshin
Të gjitha bukuritë që më takonin
Kur bashkë me to
E imja s'ishe ti.

MALLI

Nuk është egoiste
Të mendosh kur je vetëm,
A mendojnë për ty ata që të njohin,
Miqtë e të dashurit,
Shokët e tu gjithandej.
Duke sjellë ndër mend fytyrat e tyre,
Gjestet dhe zërat
Çastet e rëndomta të jetës fiksuar në ty
Kudo ku ke shkelur përmbi tokën tënde.

E megjithatë,
Ky mendim të trishtoka pakëz
Dhe të bën të vështrosh larg,
Diku larg.
Malli është largësia e shndërruar në
dhembje
Dhe dhembja gjithmon s'na pëlqen
Sadopak.

1975

MARRËVESHJE

Bëra një marrëveshje intime me pranverën.
Ç'pjesë më takon nga gjelbërimi yt,
Nga ditët që zgjaten dhe netët që ngrohen,
Nga hapësirat e najlonta që ndrisin njëra-
-tjetrën?

Ç'pjesë më takon nga kori i shpendëve,
Nga aroma e klorofilës «made in dielli»,
Nga ringjallja e dheut dhe mufatja e ujit,
Nga sythat që bëhen lulë dhe lulet që fruta
bëhen?

Mos harro, e dashura ime,
S'të dua vetëm për vete,
Kam një mijë dashuri që gjallojnë rreth
meje.

Bëra një marrëveshje intime me pranverën:
Merre zemrën, këmbanë ma bëj
Të kumbojë anonime në orkestrën tënde!

1985

MOTRA IME

Motra ime Tefte,
Motra ime e mirë
Çfarë i jep ti botës, motra ime?

Ti i do kaq shumë njerëzit, tokën, yjet,
Këngët, gjelbërimin, valët, ëndërrat,
Ti e do kaq shumë diellin, horizontet
Ditët, netët, plazhet edhe fshatrat,
Dhe të dhëmb kaq shumë çdo dhëmbje e
botës

Lotin ia fal ti gjithkujt që vuan.

Motra ime Tefte,
Motra ime e mirë
Ç'më mundon e lodh kjo vjershë për ty
Moj motra ime!

1974

PRAGMBRËMJE

Në fushën e gjerë po binte mbrëmja,
Hapësira mbyllej si sy i madh
Ngadalë.

Yjet i afroheshin tokës,
Të gjitha ngjyrat shkonin drejt ngjyrës
gri,

Dhe era e lodhur
Kryet pështeti në fijet e barit.

U ktheva rreth vetes.
Terri hovin i preu vështrimit.
Pëshpërta diçka,
Thirra një emër,
Këndova një këngë
Duke dëgjuar kumbimin si zog të lumtur
Mbi fushë,
Duke menduar atë,
Të bukurën gjer në mosthënie
Që e shprehim me katër germa:
«Jetë».

Më dehu mendimi
 Dhe yjet që erdhën pranë gjer në prekje.
 I thirra dikujt që u ndodh aty pranë,
 O mik,
 Pa ndalu, ta bëjmë udhën bashkë!

1981

Një rrugë e re
 Për të shpëtuar
 Që të mos jetë
 I ndalur kështu pranë
 Që të mos jetë
 I ndalur kështu pranë
 Që të mos jetë
 I ndalur kështu pranë

NJË RRAP E NJË PJERGULL

Një rrap e një pjergull
Krah më krah pështetur.
Të dy gjethezemër.
Tok e rrojnë jetën
Një rrap e një pjergull.

Në fushën e ditës
Hijet rrotullohen,
Pjergulla harliset.
Drejt qiellit vrapojnë
Një rrap e një pjergull.

Ç'lidhje e bukur vallë
I mban kështu pranë?
Ç'përqafim i ëmbël
Pemët gjethezemër
Një rrap e një pjergull?

Të mendova ty,
E dashura grua,
Dhe i thashë vetes
Ja kështu të rrojmë
Si rrap me pjerguli.

Kemi krahë të rrojmë,
Jeta është e gjatë.
Jeta për të rrojtur
Vdekja për të vdekur.
Një rrap e një pjergull...

1983

NATË

Murmurima e murme e natës.
Lojë e territ me xixëllonja drite.
Ngre kokën e pagjumë nga shtrati,
Gruaja fle. Flejnë fëmijët.

Ç'gjë është ajo që s'më lë të përgjumem?
Krifën e gjelbër shkundin mendimet.
Jorganin e natës ke flakur mënjanë
Dhe mendjen e vret,
E vogla mendja ime.

Ti punon e punon aq palodhshëm sa zemra
Dhe rrëmon në eter të valëve të tua,
Nga merakun i foshnjës
Te merakun i botës,
M'i vë përpara: «Mos fli!» më thua.

AUTOTOKRATI

Jetë, moj!
E pagjuma e përjetshme,
Ç'do bëhej bota pa shqetësimet e
ndershme?!

1984

AUTOPORTRET

Ç'ndodh kështu me mua vallë?

Ndiej mall

Edhe për atë re të largët në horizont

Ngjizur nga prushi i diellit dhe lëngu i

Sikur të kemi rrojtur mijëra vjet kokë më
tokës,
kokë

T'ia njoh e të m'i njohë hallet

Ajo re e vogël.

Ç'ndodh kështu me mua vallë?

Kuptoj frymëmarrjen e dheut

Dhe kollën e lehtë të çdo bime,

Zogjve me emër u flas në fluturim.

E gjej vetveten

Në çdo magji të materies,

Më dhëmb a kënaq çdo gjë si trupi im.

Ç'ndodh kështu me mua vallë?

Jam këtu dhe njëkohësisht kudo,
I pranishëm si ajri.
Çdo lumë të botës e kam lumë të fëmijërisë
sime.

Më trego një përrallë në çdo gjuhë njeriu,
Të të them se treguar ma ka
E mira gjyshja ime.

Ç'ndodh kështu me mua vallë?

Gëzohem nga çdo gëzim i ndershëm
Dhe dua të duhem nga çdo e bukur që
rron.

Ndodh të më dalë gjumi e të ndez cigaren
Për një student të vrarë në Kili
A një zezak në Angolë.

Ç'ndodh kështu me mua vallë?

Po të mos më dhembë zemra,
S'kam zemër.
Po të mos më shohë syri,
S'kam sy.

Në s'gjeçi njeri që të flasë keq për mua,
Jetëhumbur qenkam,
Thomëni ta di.

Ç'ndodh kështu me mua vallë?

Sa më shumë rroj
Aq më shumë dua,
Sa më shumë këndoj
Aq më shumë m'u kënduaka.
Trishtohem, gëzohem,
Jetoj e përpiqem
Që ditët e mia të kenë emrin tim.

1985

THE ME DEBON

*Ngjyrimet
e stinëve*



TOKË ME DËBORË

*Me orë të tëra eca në dëborë,
Sikur kisha humbur çdo lidhje
Me tokën.
Sytë m'i përleti hapësira e bardhë,
Si binjakë
Ngjanin horizontet.*

*Kur u zbulua diku
Dheu i murrmë, kafe,
Qëndrova një çast,
E mora në pëllëmbë.*

*Pak orë të ndaheshke nga ty
Të marrka malli,
Moj nënë!*

1984

NDËRROHEN STINËT

*Në fund të vjeshtës dhe në prag të dimrit,
Ditë nga kalendari i zakonshëm i vitit.*

*Ndoshta këto ditë
Të zakonshme tamam nuk janë,
Ashtu si nuk janë të veçanta tamam.*

*Po gjithkush,
Ditët e tij i njeh,
Siç njeh bariu tufën e vet.*

*Nën rrugët tona tani ujërat rrjedhin,
Mbi rrugët tona tani retë rendin;
Jeta — më e bukura gjë
Midis tokës e qiellit.*

*Vazhdon gjetherënia masive nga pemët,
Njeriu lulëzon si qenia më e gjelbër.*

Në prag të dimrit dhe në fund të vjeshtës...

1980

ERA

*E dua erën,
shpirtin e lirë të natyrës,
lëvizjen konkrete të materies.
Ngre dallgë, shtie gjethe, bën furtunë,
bareshë tekanjoze e reve.*

*E dua ta ndiej në ballë e në gjoks
Dhe krehër për flokët
Ta kem.
E dua, ta di që jam gjallë,
E dua, që rroj, ta ndiej.*

*Botën pa të, kaq s'do ta doja.
Brenda meje mos ish,
Veten nuk do ta çmoja.*

1975

KUR FILLON STINA FLOKËVERDHË

Gjithmonë e desha këtë stinë,
Pak tekanjoze,
Pak çapkëne,
Po aq bujare sa askush.

Në tokë tani zë fill buka e ardhshme
Dhe qiejt vishen si qelqe prej avullit,
Si gjinjtë e vajzave zënë e rriten ujrat
Në shtrat të tyre pak nga pak.

Dhe horizontit tutje-tëhu
Lëvizin erërat rebele,
Mes drurëve gjetherënës, hurmat
Bëhen tani inkandeshente.

Gjithmonë e desha këtë stinë,
Ndonëse kam qenë dhe jam mik i
pranverës.

1979

NË PARK

Në park s'është mirë të jesh vetëm
Po unë dhe kështu jam i lumtur,
Ul sytë në qilimin me gjethe
Sikur diçka të kem humbur.

Ç'kërkoj, as vetë s'e di,
Me zemrën që kurrë s'rri qetë,
Më ngjan se këtu e kam mik
Çdo ashkël prej druri, çdo fletë.

Njoh gjuhën e barit dhe pemës,
Kur bëjnë me erën dialog,
Di ndjenjën e gjethes që bie
Dhe sythin që zë belbëzon.

E njoh çdo bisedë prej zogu
E gjer te çdo gjurmë insekti,
Kështu është, se ndryshe s'do isha
I tillë, me damar prej poeti.

PAS SHIUT

Gjithçka u la.
Banjë e madhe e hapësirës.
Zgjas dorën të prek konturin e malit
Dhe ndiej si më shpojne gishtërinjtë
halëpishat.

Koha rend
Dhe çasti plak çastin.
Jam tepër i sertë për të thënë se e dua
Me gjithë ç'mban shpirti
Këtë botë rreth meje.
Lum si ju
Që ç'kishit për të thënë, e thatë!
Më vjen t'u thërras
Kua jve të bardhë, barrëshkarkuar
Të reve.

1984

PLA JETI TOKI

*Te ky planet
i vogël rrojmë*



1870
The
i

PLANETI TOKË

Ky planet i vogël ku rrojmë,
Që vrapon i shqetësuar në orbitat kozmike,
Si i kalluri në flakë që i ikën holokaustit
të vet,

Ky planet i vogël ku rrojmë,
Që i dha universit qenien me mendjen më të
lartë
E që të fshehtat s'i ka më në xhungla e
funddete
Po pikërisht te kjo mendje ku u ngjiz
mjeshtëri e materies,

Ky planet i vogël ku rrojmë,
Që historinë s'ia nxënë të gjithë librat
Sikur libra të gjithë pyjet e tij të ishin
bërë,

Ky planet i vogël ku rrojmë,
Që u përskuq nga lavë vullkanesh e
revolucionesh

E varrosi në vete epoka gjeologjike,
Rende barbare, mamuthë e monarkë të
egër,

Ky planet i vogël ku rrojmë,
Bir i vogël i familjes së madhe të Diellit,
Thërrmijë e vogël e Kozmosit të madh,

Ky planet i vogël ku rrojmë,
Që e duam mbi veten
Dhe ia ndiejmë çdo dhimbje sikur trupi
ynë të na dhimbte,

Ky planet i vogël ku rrojmë,
Që bëri në pëllëmbën e tij në miliona vjet
njeriun,
Sot vetë në pëllëmbën e njeriut është
Dhe vë në provën finale gjeninë e veprës
së tij.

JETOJ SYHAPUR

*E pashë diellin në sy,
Sytë më lotuan.*

*E pashë dashurinë në sy,
Sytë më lulëzuan.*

*E pashë bukurinë në sy,
Sytë m'u zbukuruan.*

*E pashë vdekjen në sy,
Sytë m'u trimëruan.*

*E pashë të keqen në sy,
Sytë s'më tradhtuan.*

*Për gjithçka që ka bota,
Kam sy dhe rroj syhapur.*

E PYETA DETIN

E pyeta detin:

O mik, si nuk u lodhe,

Një jetë të tërë kësaj toke

Me shamibardhën valë i fshin djersët?

Dhe ai tha:

Si mund të lodhem,

Kur asaj kurrë s'iu mbaruan hallet,

O vëlla?!

1982

NJOHJE

Veten e njoh nga ëndrrat e fjetura,
Ditën e njoh nga syri i diellit,
Njerëzit i njoh nga fjalët e pathëna.
Jetën e njoh si lëvizje të njerëzve,
Popujt i njoh kur bëjnë historinë,
Historinë e njoh si jetëshkrim të popujve.

1980

TI JE IMI, QIELLI IM

(poemë)

1.

Ti je imi,

Qielli im!

Kam dyzet vjet që të shoh

Ditë e natë,

I pranishëm je në çdo gjë që bën jetën
time.

Ta kam ndier rënkimin

Skaj më skaj,

Ortekun e gazit që bubullon me rropamë

E përplasat në brigjet që s'janë,

Kam deshifruar hieroglifet e tua pa fund

Si një shkrim të mistershëm natyre

Të mpiksur shumë kohë para kohës që
rroj.

Botëra që vdesin,
Botëra që lindin,
Ngjallnin në mua mesazhe që shkencë s'i
njuh.

Ti je imi,
Qielli im!
T'i njoh rrugicat yjore
Si mëhallën time,
Yllësitë e mbledhura kokë më kokë
Si familje.

T'i njoh galaktikat — vaporë të bardhë
Që vijnë nga larg, dritandezur,
Pelerinën tënde universale
Që ngjyrën ndryshon në çdo stinë tokësore,
Në çdo orë të ditënatës.

E njoh fuqinë e zjarrit tënd
Dhe ftohtësirën e akullt të hapësirave të
tua.

T'i kam parë yjet
Të qeshur a të ngrysur,
Yjet që dimrit tkurren e mblidhen
Dhe verës pikojnë lëngun e ndritshëm,
Yjet me emra të bukur njerëzorë
T'i kam ndjekur xixëllonja
Fushave të fëmijnisë sime.

Ti je imi,

Qielli im!

I hedh këto fjalë si një bumerang të madh
Të vërtiten pa fund

Në madhështinë tënde të lodhshme

Dhe të kthehen tek unë me gjëmimin

vigan:

«I yti, i yti jam,

O njeri i Tokës!»

2.

Fëmijë, duke u mëkëmbur

Udhëve të mia të shkurtra,

Kam ëndërruar të shkelja në udhët e tua,

Të humbas me një frikë mrekulluese

Në trafikun tënd kozmik,

Sepse gjithmonë do t'i gjeja përsëri

rrugicat e mia të vogla,

Atë grimcë që bën Toka ime

Në vorbullën tënde gjigante,

Ashtu si Ulisi që dhe një mijë vjet të

humbiste

Do ta gjente Itakën.

Të kam thirrur.

Me gjithë forcën e kraharorit tim

Të kam thirrur

Dhe më është dukur se ndieja
Jehonën e zërit tim
Pasuruar në polifoninë tënde pa skaj.

Më ke habitur, trullosur
Me qenien tënde vigane
Dhe kam dëshiruar të kem diçka nga ty;
Mos isha kështu, i vogël,
I brishtë e kaq jetëshkurtër.
Herë të kam dashur me vrull e i etur,
Herë të kam urryer
Kur më tregoje pafuqinë e vetvetes.

3.

Po ti nuk e di.
I njeh ti, vigani i përjetshëm,
Dëshirat e qenies së vogël?
Dhimbjet, gëzimet, mendimin e rëndë
Që e shoqërojnë me rritjen e tij
Gjithë jetën.
Që sa ngrihet në këmbë?

Se ti je i madh, i pafund,
Qielli im!
Po prapë,
A s'të lind dhe ty një dëshirë e fshehur?

Të bëhesh i vogël, filiz delikat,
Të ecësh me këmbë e të hash me duar,
Të qash si fëmijë, të luftosh si burrë,
Të dashurosh e të ndiesh gjakun tënd
Si përçohet i valë te fëmijët e tu.

Të jesh i vdekshëm si unë,
Miku im,
Të nxitohesh për të thënë
Atë që zemrës të vlon,
Të urresh
Atë që dashuria jote të urdhëron,
Të mos ndalesh kurrë
Dhe të shohësh si nga shputat e këmbëve
Plagosur nga udha,
Ka ngrirë gjaku yt
Stalaktite rubini.

Mos e ndjefsh kurrë këtë dëshirë,
Qielli im!
Se do të ishte një mundim sfilitës për ty,
Një mundim asgjësues
Më i egër se zjarret e yjeve të tu,
Se furrat ku materia përvëlohet në flakë.
Ti do të dridheshe i tëri si një qenie
mjerane
I shkatërruar nga një mundim
Që s'do t'i bëje dot ballë.

4.

Qielli im,

Miku im!

Të kam parë me sy të lirë e të pastër,

Me sy të gëzuar, të turbullt, të vrarë,

Me sy të përmalluar, të menduar,

Të enjtur nga pagjumësia

Të shqyer nga urrejtja,

Të kam parë me sy të dashuruar.

Të kam parë nën thjerrzën e lotit,

Kam kërkuar ndihmë nga ty.

Dhe ti ke hedhur një meteor të flaktë,

Atë trajektore të ndezur që më rri në sy,

Dhe ke thënë:

«Thuaj një dëshirë,

Biri im!»

E kam pëshpëritur dëshirën me buzët që
digjnin

Dhe prita e prita me ankth prej fëmije

Dhe pashë si shpërftytyroheshe ti

Syve të mi të përlotur.

Krijoheshin përbindësia në hapësirat e

tua,

Kuçedra të frikshme shumëkokëshe.

M'u duke i shëmtuar,

Më fal, qielli im!
Si fusha jonë e futbollit
Kur ktheheshim shtëpive të mundur.

I rritur, e kuptova se s'ish faji yt.
Se s'duhej të rrija e të prisja ashtu
Që ti të ma hidhje në pëllëmbët e etura
Dëshirën e gatuar, kërkuar prej meje.
Se ti më mësoje një vrull të pashoq
Dhe zjarri që ndizje në gjoksin tënd të
madh
Ish shembull për zjarrin
Që duhej të ndiqja në jetë.

Po. Ti më ke ndihmuar,
Qielli im!
Më dhe sy dhe ëndrra të bukura.
Sikur të isha qenie e nëndheshme,
Pa ty, as tokën, mëmën time, s'do ta çmoja.
Pa ty, ç'formë përçude do të merrte jeta?
Do ishim insekte të mëdha
Në thellësi të planetit.

Po. Ti më ke ndihmuar
Qielli im!
Të kam menduar ty në hall e në vuajtje,
Kur s'dinte mendimi i vogël

Të dilte nga labirintet e çuditshme të jetës.
Jam zënë pas krifave rozë të kometave të
tua

Gjer në hapësirat e largëta
Ku metamorfizohet materia.
Ti më tregove jetë të tjera pa numër
Dhe i vure cak egos sime prej njeriu,
Se me çdo gjë, qenia e vdekshme ngopët,
O mik,
Vetëm për jetën nuk do thoshte «Mjaft!»
kurrë.

Por ti më mësove bukurinë e vdekjes së
vogël,
Të pjesshme,
Kuptimin pa të cilin jeta do hiqej zvarrë
Monotone,
Pa të cilin stimul nuk do kish për jetën.
Vetëm tek ti jam i pavdekshëm,
Qielli im!
Atomët e mia shpërbëhen e s'humbin
kurrë.

Rroj në jetën tënde pafund,
Unë,
Mikrosekonda e kohës sate të madhe.

5.

Jam rritur me ty,

Qielli im.

Të kam parë paprerë

Në udhët ku eca dhe ku ëndërrova,

Në majat e maleve që zgjaten drejt teje,

Në plazhet ku vala flet gjuhë njeriu.

Të kam parë

Mes ndryshkut të gjetheve në vjeshtë

Dhe mes klorofilës

Që festën ka në pranverë.

Të kam parë mes punës,

Qielli im!

Duke mbajtur mesin e dhembur nga

lodhja.

Të kam parë ndenjtur a shtrirë,

Me duart nën kokë,

Mbi këtë tokë që e dua si atdhe të

njeriut.

Të kam parë nga dritarja ime,

Kur mbi karrige ishte

Fustani i bardhë i gruas sime nuse.

Të kam parë kur grindej e qante

Në mesnatë fëmija.

Ngrija sytë dhe shihja sahatin tënd

gjigant.

Ti flije,

Unë s'flija.

I kam lëshuar sytë
Të kullosin tek ti,
Si dy shqerra naive të lazdruara
Të brejnë me dhëmbëza pak gjelbërim
nga yti.

I kam lëshuar sytë tek ti
Kur kam dashur t'i iki vetvetes,
Sa të mundem më larg,
Sa të mundem më thellë,
I zbardhur nga pluhuri ndëryjor,
Me nebulozat e bardha duke fshirë
djersën.

Qielli im,
Miku im!
Kuptoje njeriun.
që bën jetën tek ti.

6.

Nuk kam besuar kurrë
Se tek ti është zoti,
O qiell!
Ti vetë je zoti i fatit tënd të përjetshëm.
I madh, i pushtetshëm, i hapësirtë,
Dritën e plak skajeve të tua të paskaj
Dhe vetë nuk plakesh.

E mashtronin të varfërin me ty
Si shtëpi e mistershme zotash të gënjeshtërt.
E mashtronin me lulëzimin e parajsës
Dhe kutërbimin e ferrit.

Por prapë ishe ti,
Zëmadhi i pagojë,
Largpamësi i pasy,
Ishe ti që e ndihmove atë të kuptojë,
Se të gjitha i ka në vetvete,
Në Tokën e tij.

7.

Kemi një planet të bukur,
Qielli im!
(Mos më përqesh e më tall
Nëse ti ke miliona të tillë!)

Kemi një planet të bukur
Nga ku ti dukesh njësoj i madh e i bukur.
Edhe nga mali Korab
E malet e rënda të Ballkanit,
Nga Apeninet, Uralet, Himalajet e larta,
Nga Kordilieret dhe Andet,
Nga shkretëtirat dhe fushat pjellore,
Anëdetet dhe buzëlumenjtë anëmbanë.

Dashurinë për dheun e të parëve tanë
S'e ndaj kurrë nga dashuria
Për ty.
Kush harron tokën dhe rri sy për pjetë
Gjunjëgjakosur bie ai.
Kush kockën kurrë se ngre lart e s'të sheh
ty në jetë
Mbetet pa sy.

Kur vjen e pështetesh i lodhur
Me bërrylin në shpatull të maleve tona,
Ta dalloj në sy
Lotin e avulluar të njeriut,
Djersën, gjakun e përpkjekjes së tij,
Barutin që shpiku për të vrarë vetveten,
Kollën e madhe që quhet industri.
Sepse në mijëra vjet që jetën e tij ai rro:
Një pjesë të hapësirës sate
Ka thithur e nxjerrë nëpër mushkëri.

Ndaj e huaj nuk është
Asgjë e jona tek ti
Dhe unë tek ti dalloj
Zjarrin e Brunos së djegur,
Kopernikut i gjej rënkimin e thellë,
Gjej avujt e plumbit të miliarda shkronjave
Që radhiti njeriu
Drejt së vërtetës.

Oh, sa e mundimshme është e vërteta
Qielli im!

Janë përpjekur ta fshehin
Më shumë se ç'të fshehin ty retë.
Vitet plaknin vitet
Dhe shekujt plaknin shekujt,
Vraponte me alarm tek ti
Ky planet.

8.

Ky planet,
Kokërr rëre në pëllëmbën tënde
Që pëllëmbën ta djeg me hallet e tij.
Provo të hyje ti në këto halle,
Do humbje i gjithë,
Qielli im!

Është kaq e vështirë
Nganjëherë të buzëqeshësh,
Sa ç'është e vështirë një yll tek ti
Të lindë.
Shumë forcave të errëta u vuri fre njeriu
Tani i duhet freri për teprimin e tij.

Se është një çudi e madhe
Ky njeriu,
O mik!

Mos e shiko nganjëherë kështu të brishtë
E të dobët
Teksa shqyen sytë ta dallosh
Prej lartësive të tua.
Kur ai natyrës i hyn në të fshehtat e saj
Dhe misteret që flenë ia zgjon
E ia njeh,
Mund të ndodhë
Më e rrezikshmja qenie të jetë,
Të shkatërrojë të gjithë një botë,
Të shuajë jetën
Në gjithë një planet.

Eh, qielli im,
Që ngjan se vëzhgon çdo gjë me shpërfiljen
tënde
Prej të madhi!
Nëse mendimit i japim krahët e hapësirave
të tua
Dhe zemrën,
Atë të voglën sa grushti i njeriut,
E bëjmë mbështjellëse
Për gjithçka mban ti brenda;
Nëse synojmë shëmbëlltyrën tënde,
Harmonitë, energjitë e tua vitale,
Kjo do të jetë në të mirën tonë,
Qielli im,
Dhe gëzimi i këtij dheu

Do të ishte një diell i ri,
I paparë në bashkësitë e tua yjore.

Por hallet e botës së sotme
S'na bëjnë të të harrojmë ty,
Dhe nuk do lëmë që ty të të shëmtojnë
Raketat e luftës,
Satelitët spiunë.
Kufij s'do të lëmë të ndajnë tek ti
Ata që nga frika e luftës
Jetojnë me luftë.
Qelizë për qelizë
Jetën e arsyeshme do të mbjellim një ditë
Vetinë më të bukur
Që ka materia pa shpirt.

Nuk jemi ëndërrimtarë të kotë,
Qielli im!
Çdo jetë njerëzore na vlen si përvojë
Në udhën ku njerëzimi synoi në shekuj.
Një ditë
Njeriu do t'i zgjidhë hallet mbi Tokën e tij
Dhe do të ketë kohë
Më shumë me ty të merret.

9.

Kush kërkoi të drejtën
Dhe nuk të deshi ty?

Kush mendoi për të bukurën
Dhe nuk të deshi ty?
Kush ëndërroi për të ardhmen
Dhe nuk të deshi ty?

Nga skllavi i lashtë që flakte zinaxhirët,
Eujkrobi i mjerë
Që flakën u vinte sarajeve,
Proletari i sfilitur kryengritës,
Te çdo komunar, rebel ndaj rendeve

shtypës

Dhe çdo mendimtar
Që raca e njeriut i dhimbej,
Tek ata që revolucionet ia ndezën planetit
Si pishtarë të mëdhenj
Verbërinë për t'i djegur;
Nga njeriu i lashtë
Tek njeriu i ri,
Askush nuk luftoi pa të pasur ty në zemër,
Askush s'jetoi pa të pasur ty
Në sy.

Ti e ndihmove njeriun
Të ngrihet më këmbë
Mbi tokën e tij.
Prej tij sot askush s'të fsheh,
S'të rrëmben e s'të vjedh,
As burri i shtetit që supershtetit i hipën
si kalë,
As biznesmeni xhambaz

Që ëndërron bankën tënde qiellore,
As diktatori,
Qenia antinjeri që zili ta ka forcën
Dhe urren dritën tënde,
As burokrati zyrtar e meskin
Që të imiton ty me mizanskenat vulgare.
I njeriut ke qenë,
I njeriut do jesh!

Janë përpjekur shumë të të vidhnin ty.
Kurdoherë në modë
Vjedhja jote ka qenë,
Por ti gjithmon na ke thirrur:
«O njerëz!
Mos e merrni kurrë surrogaton për mua,
Atë copë beze me bojëra e ngjyra
Që u japin për qiell!
Qielli jam unë,
I drëkshmi, frymori,
Shikmëni në sy
Që kurrë mos më harroni!»

Oh, sa e dhimbshme është,
Qielli im!
Të rrosh të tërë një jetë
Dhe të mos të shohësh dot ty
Të gjallin e vërtetë!

Por ti je imi,
Qielli im!
Askush s'të vjedh prej meje.
Të kam njohur gjer tek atomi yt më i
largët
Që i thërret me një zë prej vëllai
Atomët e qenies sime.
Të kam njohur,
Askush s'ma hedh dot.
Do të të gjeja edhe i lodhur,
I vrrarë, i dërrmuar nga udha e gjatë,
I hutuar, në gjumë,
Bile dhe i vdekur të isha.
Ti je imi,
Qielli im!

10.

Po, unë e besoj,
Qielli im!
Një ditë do të ketë kohë
Më shumë me ty njeriu të merret,
Për të mirën e tokës së tij
Dhe të jetës së tij,
Për qëllimin pse rron
Dhe zgjat fisin e tij nëpër shekuj,
Mbi këtë planet si kalë të harbuar
Që endet
E endet
E endet.

Se do vijë një ditë,
Besoje dhe ti,
Qielli im!

Se do të vijë një ditë kur unë, njeriu,
Bir i miliona brezash njeriu,
Me këmbët e mia të forta
Mbi dheun tim të fortë,
Do ta marr timonin e shtjellës sate në duar
Dhe do të ndez në gjirin tënd
Një yll vigan
Që teksa shuhet thellë viseve të tua,
Të të them siç më thoshe kur isha i vogël:
«Mendo një dëshirë, ati im,
Mendo një dëshirë
Dhe ma thuaj!»

PËRMBAJTJE

Përherë	3
DITË, JI E BUKUR	5
Ditë, ji e bukur	7
Pas mesnate	8
Dialektike	9
Më iku dita	11
Poeti	13
Kruja natën	14
Rinia qesh	15
Natën e mirë, Sagitë	16
Bukuria	18
Shiu pas thatësirës së gjatë	19
Mikronjeriu	21
Kritikë	23
II. JETË	25
Jeta lind	27
Në veten time	28
Njeriu	30
Vegin	32

Një fill bari	33
Tek ura e Matit	34
Jam rob i bukurisë njerëzore	35
Hapat e mi	36
Qyteti i studentëve	37


III. ZËRA QË NGA LARG MË VIJNË

Rrënjët	41
Eci mbi ty	42
Qemal Stafa	43
Atdheu	45
Dhjetë variacione për Gjergj Elez Alinë (poemë)	47

IV. SE ÇDO NJERI E KA NJË ZEMËR

Dashuria	57
Ura	59
Shegët	60
Mbrëmje	61
Me ty	62
Mëngjes	63
Pagjumësi	64
Lirikë	65
Atë ditë	66
Malli	67
Marrëveshje	68
Motra ime	69
Pragmbrëmje	70
Një rrap e një pjergull	72
Natë	74
Autoportret	76

V. NGJYRIMET E STINËVE	79
Tokë me dëborë	81
Ndërrohen stinët	82
Era	83
Kur fillon stina flokëverdhe	84
Në park	85
Pas shiut	86
VI. TE KY PLANET I VOGËL RROJMË	87
Planeti tokë	89
Jetoj syhapur	91
E pyeta detin	92
Njohje	93
Ti je imi, qielli im (poemë)	94



Kombinati Poligrafik Shkup
 Titov, 1988



BETIM MUÇO

Libra të tjerë të autorit:

- Rrugëye të atdheut
(poezi) 1968
- Etyde
(poezi) 1972
- Ekspres
(tregime) 1975
- Tregime
1978
- Kokrra gruri
(poezi) 1978
- Ditë që vështrojnë larg
(roman) 1982
- Ditëlindja e këngës
(poezi) 1983
- Është se ç'na është
(përralla) 1984
- Plumbi i gërmave
(tregime) 1985
- Gjurma e vetëtimës
(roman) 1986
- Bota në sytë e Dolës
(përralla) 1986

4 lekë